



FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

www.qpz.gov.al

Nr.27

29 mars

2012

P Ë R M B A J T J A

		Faqe
Vendim i GJK nr. 14, datë 26.3.2012	Me objekt shfuqizimin si antikushtetues të vendimit nr. 12, datë 18.2.2008 të Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda dhe vendimit nr. 00-2010-1078 (398), datë 28.4.2010 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë.....	1337
Vendim i GJK nr.15, datë 26.3.2012	Me objekt shfuqizimin si antikushtetues të vendimit nr. 326, datë 2.6.2006 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pogradec; të vendimit nr. 286, datë 14.12.2006 të Gjykatës së Apelit Korçë dhe të vendimit nr.00-2009-206, datë 13.3.2009 të Gjykatës së Lartë.....	1346

VENDIM
Nr. 14, datë 26.3.2012

NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Bashkim Dedja	Kryetar i Gjykatës Kushtetuese		
Vladimir Kristo	Anëtar i	“	“
Xhezair Zaganjori	Anëtar i	“	“
Petrit Pllaçi	Anëtar i	“	“
Vitore Tusha	Anëtare e	“	“
Sokol Berberi	Anëtar i	“	“
Fatmir Hoxha	Anëtar i	“	“
Altina Xhoxhaj	Anëtare e	“	“
Admir Thanza	Anëtar i	“	“

me sekretare Enina Mullaj, në datën 18.10.2011 mori në shqyrtim në seancë gjyqësore çështjen me nr. 34,43/10 Akti, që i përket:

KËRKUES: Ermal Nika, përfaqësuar me prokurë nga avokate Nurihan Meta.

Ylli Kapo, Gentian Baba, përfaqësuar me prokurë nga avokat Vasil Plaku.

SUBJEKT I INTERESUAR: Prokuroria e Përgjithshme, në mungesë.

OBJEKTI: Shfuqizimi si antikushtetues i vendimit nr. 12, datë 18.2.2008 të Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda dhe vendimit nr. 00-2010-1078 (398), datë 28.4.2010 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë.

BAZA LIGJORE: Nenet 42, 43, 131/f dhe 134/g të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; neni 6 i Konventës Europiane për të Drejtat e Njeriut (KEDNJ).

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatorin e çështjes, Admir Thanza, përfaqësuesit e kërkuessve që kërquan pranimin e kërkesës, dhe pasi bisedoi çështjen në tërësi,

VËREN:

I

1. Nga aktet e administruara gjatë gjykimit në Gjykatën e Shkallës së Parë për Krime të Rënda, rezulton se më datë 16.7.2006, është sekuestruar nga policia një makinë në të cilin u gjetën lëndë narkotike. Policia ka arrestuar në flagrancë kërkuessit Gentian Baba dhe Ylli Kapo, të cilët kanë qenë punonjës policie në Drejtorinë e Policisë së Qarkut Durrës në repartin “Shqiponja”. Kërkuessi tjetër Ermal Nika ka arritur të largohet dhe nuk është bërë i mundur arrestimi i tij.

2. Në seancën gjyqësore të zhvilluar në datën 17.4.2007, kërkuessit Gentian Baba dhe Ylli Kapo, si dhe mbrojtësi i kërkuessit Ermal Nika (i cili ishte në mungesë) kërquan gjykim të shkurtuar, pasi sipas tyre, çështja mund të zgjidhej në gjendjen që ishin aktet.

3. Gjykata e Shkallës së Parë për Krime të Rënda vendosi mospranimin e kërkesës për gjykim të shkurtuar dhe si pasojë gjykimi vazhdoi sipas rregullave të gjykimit të zakonshëm. Me vendimin nr. 12, datë 18.2.2008, Gjykata e Shkallës së Parë për Krime të Rënda ka vendosur deklarimin fajtor të kërkuessve për veprën penale të “prodhimit dhe shitjes së narkotikëve” të kryer në bashkëpunim, parashikuar nga neni 283/2 i Kodit Penal (KP) dhe dënimin e tyre me 8 vjet burgim; deklarimin e pafajshëm të kërkuessve për veprën penale të “grupit të strukturuar kriminal”, parashikuar nga neni 333/a i KP-së.



4. Kundër vendimit të Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda, paraqitën ankim si prokurori i çështjes ashtu edhe kërkuesit, nëpërmjet mbrojtësve të tyre. Kërkuesit, me ankimin ndaj vendimit përfundimtar, paraqitën ankim edhe ndaj vendimit të ndërmjetëm të mospranimit të gjykimit të shkurtuar. Në përfundim të gjykimit, Gjykata e Apelit për Krime të Rënda, ka çmuar se gjykimi i shkurtuar duhej të ishte pranuar pasi të pandehurit nuk kanë kërkuar të merren prova të reja dhe Gjykata e Shkallës së Parë për Krime të Rënda ka formuar bindjen e saj mbi ato prova të paraqitura nga prokurori. Gjykata e Apelit për Krime të Rënda, duke e vlerësuar refuzimin e gjykimit të shkurtuar të gabuar, për arsye se çështja mund të zgjidhej në gjendjen e akteve, me vendimin nr. 32, datë 22.5.2008, ka vendosur: lënien në fuqi të vendimit nr. 12, datë 18.2.2008, të Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda, për sa i përket deklarimit të pafajshëm të kërkuesve për veprën penale të “grupit të strukturuar kriminal”, si dhe deklarimin fajtor të kërkuesve, për veprën penale të “prodhimit dhe shitjes së narkotikëve” të kryer në bashkëpunim, dhe në zbatim të nenit 406/1 të Kodit të Procedurës Penale (KPP), i ka dënuar përfundimisht me 5 vjet e 4 muaj burgim, duke aplikuar uljen e dënimit me një të tretën.

5. Përpara Gjykatës së Lartë është paraqitur rekurs kundër vendimit të Gjykatës së Apelit për Krime të Rënda, si nga njëri prej të bashkëpandehurve, ashtu dhe nga prokurori i çështjes. Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, ka argumentuar se “vendimi i Gjykatës së Apelit për Krimet e Rënda, në pjesën që bën fjalë për aplikimin e nenit 406/1 të KPP-së është marrë në kundërshtim me Kodin e Procedurës Penale” dhe ka vijuar se “duke aplikuar nenin 406, për uljen me 1/3 e dënimit të pandehurve, gjykata e apelit ka mbajtur një qëndrim të padrejtë, duke pasur parasysh se pranimi i gjykimit të shkurtuar është atribut i gjykatës së shkallës së parë dhe jo i gjykatës së apelit”. Në bazë të këtij arsyetimi, me vendimin nr. 00-2010-1078 (398), datë 28.4.2010, Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë ka vendosur prishjen e vendimit nr. 32, datë 22.5.2008 të Gjykatës së Apelit për Krime të Rënda dhe lënien në fuqi të vendimit të Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda.

6. **Kërkuesit** i janë drejtuar veçmas me kërkesë Gjykatës Kushtetuese (në vijim “Gjykata”), duke kërkuar shfuqizimin e vendimeve nr. 12, datë 18.2.2008, të Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda dhe nr. 00-2010-1078 (398), datë 28.4.2010, të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, për arsye se këto vendime u kanë cenuar atyre të drejtat kushtetuese të sanksionuara në nenet 4, 17, 18, 42 dhe 43 të Kushtetutës. Më konkretisht kërkuesit pretendojnë se:

6.1 Kërkuesit i është mohuar e drejta e ankimit ndaj një vendimi gjyqësor të padrejtë në gjykatën më të lartë;

6.2 Gjykatat kanë vendosur përtej diskrecionit të njohur nga Kushtetuta, duke cenuar parimin e shtetit të së drejtës;

6.3 Janë kufizuar në kundërshtim me ligjin të drejta individuale pa asnjë interes publik dhe në mënyrë disproporcionale, duke dhunuar thelbin e së drejtës;

6.4 Gjatë procesit gjyqësor është cenuar barazia e armëve ndërmjet kërkuesit dhe prokurorisë;

6.5 Gjykatat janë treguar të njëanshme, me veprime të qarta subjektive në favor të organit të akuzës, duke zhvilluar një proces të parregullt.

7. Gjykata, në mbështetje të nenit 1 pika 2 të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, në lidhje me nenin 57 të Kodit të Procedurës Civile, meqenëse kërkesat kanë lidhje dhe objekti është i njëjtë, vendosi bashkimin dhe shqyrtimin e tyre në një çështje të vetme.

II

A. Për pretendimin e cenimit të së drejtës së ankimit në një gjykatë më të lartë dhe të drejtës së aksesit në gjykatë

8. Kërkuesit kanë ngritur, *inter alia*, pretendimin se u është mohuar e drejta e ankimit ndaj një vendimi gjyqësor të padrejtë në gjykatën më të lartë, sanksionuar në nenin 43 të Kushtetutës. Neni 43 i Kushtetutës parashikon se *“kushdo ka të drejtë të ankohet kundër një vendimi gjyqësor në një gjykatë më të lartë, përveçse kur në Kushtetutë parashikohet ndryshe”*. Në çështjen në shqyrtim, Gjykata e sheh të arsyeshme të ndalet fillimisht tek e drejta e ankimit ndaj një vendimi gjyqësor, e lidhur me të drejtën e aksesit, si pjesë të pandara dhe garanci të procesit të rregullt gjyqësor, në kuptim të nenit 42 të Kushtetutës.

9. E drejta e ankimit duhet kuptuar si mundësi e çdo individi për të pasur mjete të caktuara procedurale për të kundërshtuar vendimin e dhënë nga një gjykatë më e ulët në një gjykatë më të lartë, duke i garantuar individit të drejtën për t'u përballur me drejtësinë në të gjitha nivelet e saj (*shih vendimin nr. 5, datë 2.3.2010 të Gjykatës Kushtetuese*).

10. Gjykata ka pohuar se e drejta e ankimit, e sanksionuar në nenin 43 të Kushtetutës, është një e drejtë procedurale që shërben për të mbrojtur një të drejtë substanciale. Kjo e drejtë bazohet në parimin se *“...nuk mund të ekzistojë një e drejtë pa të drejtën e ankimit”* (*shih vendimin nr. 14, datë 14.4.2010 të Gjykatës Kushtetuese*). Në funksion të ushtrimit efektiv të së drejtës së ankimit ka rëndësi të realizohet si aspekti formal/procedural ashtu edhe ai substancial. Kërkesat procedurale të ankimit janë, para së gjithash, në funksion të aksesit që duhet të kenë të pandehurit për të ushtruar efektivisht ankimin ndaj vendimit gjyqësor. Çdo instancë ankimuese që njeh sistemi i normave procedurale penale është pjesë e të drejtës së të pandehurit për të pasur akses në gjykatë. Gjykata ka vlerësuar edhe më parë se *“Administrimi i mirë i drejtësisë fillon me garancinë që një individ të ketë akses në gjykatë për t'i siguruar atij të gjitha aspektet e një forme gjyqësore të shqyrtimit të çështjes*. E drejta për t'iu drejtuar gjykatës është një nga aspektet e të drejtës për gjykim, e sanksionuar në nenin 42 të Kushtetutës. Aksesit në gjykatë duhet të jetë substantiv dhe jo thjesht formal. Mohimi i të drejtës për t'iu drejtuar gjykatës dhe për të marrë një përgjigje përfundimtare prej saj për pretendimet e ngritura, përbën cenim të së drejtës themelore për një proces të rregullt ligjor. Aksesit në gjykatë është, para së gjithash, një kusht kryesor për të realizuar mbrojtjen e të drejtave të tjera. (*shih vendimet nr. 4, datë 23.2.2011; nr. 14, datë 3.6.2009 dhe nr. 7 datë 11.3.2008 të Gjykatës Kushtetuese*). Duke iu referuar jurisprudencës së GJEDNJ-së, Gjykata ka çmuar se, veçanërisht, mjetet procedurale të ofruara nga legjislacioni i brendshëm dhe praktika duhet të tregojnë se ato kanë qenë efektive (*shih vendimin e Gjykatës Kushtetuese nr. 30, datë 17.6.2010*).

11. E drejta e ankimit nuk është absolute. Kjo e drejtë mund të jetë pjesë e kufizimeve në kuptim të nenit 17 të Kushtetutës dhe në respektim të standardeve që ky nen përcakton. Gjykata ka theksuar se Kushtetuta, si rregull, nuk përjashton ndonjë të drejtë themelore nga kufizimi dhe, në këtë kuptim, vlera e nenit 43 të Kushtetutës nuk mund të qëndrojë e ndarë nga vlerat e tjera kushtetuese siç është dhe ajo e rasteve përjashtimore për kufizimin e një të drejte themelore (*shih vendimin nr. 12, datë 14.4.2010 të Gjykatës Kushtetuese*).

12. Në funksion të garantimit të së drejtës për t'u ankuar ndaj një vendimi gjyqësor penal, neni 43 i Kushtetutës implementohet nga nenet 407-421 të Kodit të Procedurës Penale që disiplinonjë ushtrimin e ankimit. Mbi bazën e këtyre dispozitave, është ligji ai që cakton rastet në të cilat vendimet e gjykatës mund të ankimohen, si dhe mjetin e përshtatshëm ankimues, që mund të jetë apeli, rekursi në Gjykatën e Lartë ose kërkesa për rishikim, duke parashikuar aspektet formale dhe afatet procedurale për ushtrimin e këtyre mjeteve ankimuese. Në vështrim të këtyre neneve, Gjykata vëren se nuk ka ndonjë dispozitë procedurale penale që të kufizojë të drejtën e ankimit.

13. Sipas rregullimeve të parashikuara në dispozitat procedurale penale, objekt i ankimit, përveç vendimeve penale përfundimtare mund të jenë edhe vendimet e ndërmjetme të gjykatës. Në



kuptim të nenit 407 të KPP-së ankimi kundër vendimeve jopërfundimtare dhe urdhrave të gjykatës mund të bëhet vetëm me ankimin kundër vendimit përfundimtar, përveçse kur në ligj parashikohet ndryshe.

14. Për sa i përket kërkesës për gjykim të shkurtuar, neni 404 i KPP-së, disponon se gjykata e shqyrton këtë lloj kërkesë përpara se të fillojë shqyrtimi gjyqësor dhe kur çmon se çështja mund të zgjidhet në gjendjen që janë aktet vendos të pranojë gjykimin e shkurtuar. Në të kundërt, ajo e refuzon kërkesën dhe vazhdon me gjykim të zakonshëm. Vendimi i gjykatës, si në rastin kur pranohet gjykimin e shkurtuar, ashtu edhe kur e refuzon atë, është një vendim i ndërmjetëm.

15. Në lidhje me pretendimin e cenimit të së drejtës së ankimit, ndaj vendimit të ndërmjetëm të mospranimit të gjykimit të shkurtuar, në një gjykatë më të lartë, Gjykata, siç u theksua më sipër, pohon se asnjë dispozitë e KPP-së nuk e kufizon këtë të drejtë ankimi; të pandehurit, në bazë të nenit 407 të KPP-së, i është dhënë mundësia e paraqitjes së këtij lloj ankimi së bashku me ankimin ndaj vendimit përfundimtar, si për çdo vendim tjetër të ndërmjetëm.

16. Gjykata e apelit, në bazë të nenit 425/1 të KPP-së, e shqyrton çështjen në tërësi pa u kufizuar vetëm në shkaqet e ankimit. Ankimi ndaj vendimit të ndërmjetëm shqyrtohet nga gjykata e apelit, së bashku me ankimin ndaj vendimit përfundimtar. Gjykata e Lartë në vendimin unifikues nr. 2/2003 është shprehur se “Lloji i gjykimit të ndjekur nga gjykata e shkallës së parë, pavarësisht nga vendimi i saj i ndërmjetëm lidhur me kërkesën për gjykim të shkurtuar, është i rëndësishëm për qëndrimin që duhet të mbajë gjykata e apelit për ankimin e palëve të parashikuar nga neni 406/3 i KPP-së”.

17. Duke iu referuar çështjes objekt gjykimi, Gjykata konstaton se kërkuesi e ka realizuar efektivisht në apel të drejtën e ankimit ndaj vendimit të mospranimit të gjykimit të shkurtuar si në aspektin procedural, ashtu edhe substancial, pasi ky lloj ankimi i paraqitur prej tij është shqyrtuar nga Gjykata e Apelit për Krime të Rënda, së bashku me ankimin ndaj vendimit përfundimtar.

18. Gjykata vëren se Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, duke arsyetuar se “vendimi i Gjykatës së Apelit për Krimet e Rënda, në pjesën që bën fjalë për aplikimin e nenit 406/1 të KPP-së, është marrë në kundërshtim me Kodin e Procedurës Penale” dhe duke vijuar se “pranimi i gjykimit të shkurtuar është atribut i gjykatës së shkallës së parë dhe jo i gjykatës së apelit”, ka cenuar të drejtën e ankimit ndaj vendimit të mospranimit të gjykimit të shkurtuar. Shkelja që i atribuohet Gjykatës së Lartë është kufizimi që ajo i ka bërë ushtrimin efektiv të së drejtës së ankimit ndaj vendimit të mospranimit të gjykimit të shkurtuar, duke e bërë këtë vendim të pakontrollueshëm.

19. Gjykata çmon, në rastin konkret, se Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, duke penguar ushtrimin në mënyrë efektive të së drejtës për t’u ankuar ndaj vendimit të ndërmjetëm të mospranimit të gjykimit të shkurtuar, ka cenuar të drejtën e ankimit në aspektin substancial. Parimet kushtetuese që garantojnë të drejtën e ankimit duhen zbatuar jo vetëm për sa i përket shkeljeve procedurale, të cilat cenojnë të drejtën e ankimit nga një këndvështrim formal, por edhe kur jemi përpara cenimeve të karakterit substancial, që lidhen ngushtësisht me efektivitetin e mjetit ankimes. Gjykata, në jurisprudencën e saj ka tërhequr vëmendjen se të drejtat individuale, qoftë edhe të natyrës procedurale (këto të fundit të konceptuara në funksion dhe të garancive të të drejtave materiale), duhet të interpretohen gjithmonë në atë mënyrë që të jenë efektive (shih vendimin nr. 5, datë 2.3.2011 të Gjykatës Kushtetuese). Në vlerësimin e Gjykatës, shqyrtimi i mjetit procedural ankimes në mënyrë josubstanciale cenon standardin kushtetues të aksesit në gjykatë, të parashikuar nga neni 42 i Kushtetutës.

20. Edhe GJEDNJ-ja është shprehur se ekzistenca e mjetit juridik ankimes duhet të jetë mjaftueshmërisht e sigurt jo vetëm në teori, por edhe në praktikë, pasi në të kundërt mjeti ankimes nuk do të jetë i aksesueshëm dhe efektiv (shih, *Stoiçkov kundër Bullgarisë*, 24 Mars 2005 §66).

21. Në rastin në shqyrtim, pretendimi i kërkuësve lidhet me ankimin ndaj vendimit të ndërmjetëm të gjykatës, me anë të të cilit nuk është pranuar gjykimi i shkurtuar. Instituti i gjykimit të shkurtuar parashikohet nga nenet 403-406 të KPP-së dhe cilësohet nga legjislacioni procedural penal si një gjykim i posaçëm. Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë, në vendimin unifikues nr. 2/2003 janë shprehur se: “gjykimi i shkurtuar ka vlerë për ekonominë gjyqësore sepse thjeshton dhe shkurton procedurat, rrit shpejtësinë dhe efektivitetin e gjykimit dhe sjell si pasojë një përfitim për të pandehurin në uljen e 1/3 të masës së dënimit dhe mos aplikimin e dënimit me burgim të përjetshëm”. Efekti kryesor që sjell aplikimi i gjykimit të shkurtuar është caktimi i një mase dënimi lehtësuese për të pandehurin.

22. Duke pasur parasysh efektet që sjell gjykimi i shkurtuar, për sa i përket ekonomisë gjyqësore dhe veçanërisht masës së dënimit, Gjykata evidenton domosdoshmërinë e shmangies së kufizimeve arbitrare mbi të drejtën e ankimit ndaj vendimit që refuzon këtë lloj gjykimi. Zgjedhja e gjykimit të shkurtuar, si rit procesual, influencon mbi përlllogaritjen/përcaktimin e dënimit, i cili ulet me 1/3 nëse procedohet me gjykim të shkurtuar. Pra, kemi të bëjmë me një aspekt të së drejtës materiale që gërshetohet me të drejtën procesuale. Në rastin në shqyrtim, për arsye se gjykimi në shkallë të parë është zhvilluar me rit të zakonshëm, kërkuësit nuk kanë përfituar nga ulja e dënimit me 1/3. Nëse, sipas linjës së arsytimit të ndjekur nga Gjykata e Lartë, gjykata e apelit nuk ka të drejtë të aplikojë dispozitat procedurale për dënimin e reduktuar, përkatësisht nenin 406/1 të KPP-së, për arsye se në shkallë të parë gjykimi është bërë me rit të zakonshëm, atëherë ankimi ndaj vendimit të ndërmjetëm të mospranimit të gjykimit të shkurtuar nuk do të kishte asnjë vlerë për të pandehurin në funksion të përfitimit të uljes së dënimit.

23. Efekti tjetër që prodhon arsyetimi i përdorur në tërësi nga Gjykata e Lartë është krijimi i një pengese për sa i përket ushtrimit të kontrollit juridiksional ndaj vendimit të ndërmjetëm të mospranimit të gjykimit të shkurtuar, vendim i cili në këtë mënyrë bëhet i pakontrollueshëm nga ana e gjykatës së apelit. Gjykata çmon se, për të garantuar një të drejtë ankimi efektiv ndaj vendimit të mospranimit të gjykimit të shkurtuar, gjykata e apelit duhet të jetë në gjendje që të shqyrtojë e kontrollojë në mënyrë efikase ligjshmërinë e ushtrimit të diskrecionit nga ana e gjykatës së shkallës së parë në marrjen e vendimit, si nga pikëpamja procedurale ashtu edhe substanciale. Nëse gjykata e apelit, që shqyrton ankimin ndaj vendimit të mospranimit të gjykimit të shkurtuar, konstaton se çështja mund të vendosej në gjendjen e akteve dhe kërkesa e të pandehurit për gjykim të shkurtuar është refuzuar pa të drejtë, ajo ka kompetenca të ndryshojë vendimin në lidhje me masën e dënimit, duke aplikuar nenin 406/1 të KPP-së. Kjo bëhet me qëllim që të vihet në vend një e drejtë e mohuar dhe i pandehuri të përfitojë reduktimin e dënimit. Ndërsa për sa i përket rritit procesual të gjykimit të shkurtuar, ky i fundit është i parikuperueshëm në apel.

24. Edhe Gjykata Kushtetuese italiane, në vendimin nr. 313/1990 është shprehur se “përcaktimi i dënimit nuk mund t’i shmanget kontrollit juridiksional”. Po kjo gjykatë, në vendimin nr. 23/ 1992, ka theksuar se “mungesa e kontrollit mbi vendimin e gjyqtarit për mospranim të rritit të posaçëm sjell pasoja në planin e dënimit, në dëm të të pandehurit”. Ndërsa Gjykata italiane e Kasacionit është shprehur se “*në rast se është vazhduar me ritin e zakonshëm procesual, nuk ka dyshim se vendimi mund të apelohej për një motiv specifik, që është dhënia e një dënimi “të paligjshëm”(....) I pandehuri ka të drejtë të pretendojë në apel se, për shkak të refuzimit të rritit të posaçëm, në mënyrë të pajustificueshme ose të gabuar, nuk ka mundur të përfitojë nga reduktimi i dënimit, edhe pse ai i ka përmbushur të gjitha detyrimet procesuale në ngarkim të tij(...) Përcaktimi konkret i dënimit është i rivlerësueshëm nga gjyqtari i apelit, të cilit ky pretendim i kërkohet në mënyrë specifike nga i pandehuri” (shih vendimin nr. 44711, datë 27 tetor-18 nëntor 2004, të Gjykatës italiane të Kasacionit, § 5.1; § 5.2).*

25. Për sa më sipër, Gjykata vlerëson se vendimi i Gjykatës së Lartë, objekt shqyrtimi, u ka cenuar kërkuësve të drejtën e ankimit në një gjykatë më të lartë dhe të drejtën e aksesit në gjykatë.



B. Për pretendimet e tjera

26. Kërkuesit kanë pretenduar se Gjykata e Shkallës së Parë për Krime të Rënda ka vendosur përtej diskrecionit të njohur nga Kushtetuta dhe është treguar e njëanshme, me veprime të qarta subjektive në favor të organit të akuzës, për arsye se pretendimi për pavlefshmërinë e akteve është ngritur kryesisht nga gjykata dhe jo nga palët. Gjykata vlerëson se këto pretendime janë haptazi të pambështetura dhe argumentet e kërkuesve nuk janë ngritur në nivel kushtetues. Në jurisprudencën e saj gjykata e ka ripohuar qëndrimin e saj të konsoliduar se, mënyra e vlerësimit të provave dhe, në parim, mënyra e zbatimit të ligjit material është atribut i gjykatave të zakonshme (*shih vendimet nr. 23, datë 17.5.2011 dhe nr. 106, datë 1.8.2001 të Gjykatës Kushtetuese*).

27. Sipas kërkuesve, vendimi i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë u ka kufizuar të drejtën për t'u ankuar, pa asnjë interes publik dhe në mënyrë disproporcionale. Gjykata çmon se i ka dhënë përgjigje këtij pretendimi më sipër (*shih pikën A supra*).

28. Kërkuesit kanë pretenduar gjithashtu se gjatë procesit gjyqësor është cenuar barazia e armëve ndërmjet kërkuesve dhe prokurorit, pasi vetëm këtij të fundit i është dhënë e drejta e ankimit ndaj vendimit që pranon gjykimin e shkurtuar. Në lidhje me këtë pretendim, Gjykata vlerëson se, në vështrim të dispozitave procedurale penale, nuk rezulton që e drejta e ankimit t'i jetë rezervuar ekskluzivisht prokurorit; palët kanë të drejtë të ankohen ndaj vendimeve jopërfundimtare bashkë me vendimin përfundimtar (neni 407/2 i KPP-së). Si prokurori, ashtu dhe i pandehuri kanë të drejtë të ankimojnë vendimin e ndërmjetëm të gjykatës, që mund të jetë sipas rastit, për pranimin apo mospranimin e gjykimit të shkurtuar. Ligji procedural penal nuk ka vënë kufizime lidhur me ushtrimin e të drejtës së ankimit nga palët në proces në raport me njëra tjetrën, por këtë të drejtë ua njuh në mënyrë të barabartë. Si rrjedhojë, ky pretendim i kërkuesit është haptazi i pabazuar.

29. Bazuar në vlerësimet e bëra më sipër, Gjykata arrin në përfundimin se vendimi nr. 00-2010-1078 (398), datë 28.4.2010 i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë u ka cenuar kërkuesve të drejtën për t'u ankuar ndaj një vendimi gjyqësor në një gjykatë më të lartë dhe të drejtën e aksesit në gjykatë, si standarde kushtetuese, të parashikuara përkatësisht nga neni 43 dhe 42 i Kushtetutës. Si i tillë, ky vendim duhet shfuqizuar.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të nenit 131, shkronja "f" dhe nenit 134, pika 1, shkronja "g" të Kushtetutës; neneve 72 dhe 77 të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", me shumicë votash,

VENDOSI:

- Shfuqizimin si të papajtueshëm me Kushtetutën, të vendimit nr. 00-2010-1078 (398), datë 28.4.2010 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë për kërkuesit Ermal Nika, Ylli Kapo, Gentian Baba.

- Dërgimin e çështjes për rishqyrtim në Kolegjin Penal të Gjykatës së Lartë.

Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Anëtarë pro: Bashkim Dedja (kryetar), Sokol Berberi, Vitore Tusha, Petrit Plloçi, Admir Thanza, Altina Xhoxhaj, Fatmir Hoxha

Anëtarë kundër: Xhezair Zaganjori, Vladimir Kristo

MENDIM PAKICE

1. Jam kundër vendimit të shumicës për shfuqizimin e vendimit të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, për arsyet e mëposhtme.

2. Shumica, në thelb, ka çmuar se Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, duke arsyetuar se *“vendimi i Gjykatës së Apelit për Krime të Rënda, në pjesën që bën fjalë për aplikimin e nenit 406/1 të KPP-së, është marrë në kundërshtim me KPP-në”* dhe duke vijuar se *“pranimi i gjykimit të shkurtuar është atribut i gjykatës së shkallës së parë”* ka penguar ushtrimin në mënyrë efektive të së drejtës për t’u ankuar ndaj vendimit të mospranimit të gjykimit të shkurtuar, duke i cenuar kështu kërkesve të drejtën e ankimit në një gjykatë më të lartë në aspektin substancial dhe të drejtën e aksesit në gjykatë (shih § 18 dhe 19 të vendimit).

3. Shumica, ka arritur në këtë përfundim pasi ka vlerësuar se *“... kërkesat procedurale të ankimit janë, para së gjithash, në funksion të aksesit që duhet të kenë të pandehurit për të ushtruar efektivisht ankimin ndaj vendimit gjyqësor. Çdo instancë ankimuese që njeh sistemi i normave procedurale penale është pjesë e të drejtës së të pandehurit për të pasur akses në gjykatë”* (shih § 10 të vendimit).

4. Në këtë këndvështrim, shumica, arsyetimin e saj e ka mbështetur në faktin se *“për të garantuar një të drejtë ankimi efektive ndaj vendimit të mospranimit të gjykimit të shkurtuar, gjykata e apelit duhet të jetë në gjendje që të shqyrtojë e kontrollojë në mënyrë efikase ligjshmërinë e ushtrimit të diskrecionit nga ana e gjykatës së shkallës së parë në marrjen e vendimit, si nga pikëpamja procedurale ashtu edhe substanciale. Nëse gjykata e apelit, që shqyrton ankimin ndaj vendimit të mospranimit të gjykimit të shkurtuar, konstaton se çështja mund të vendosej në gjendjen e akteve dhe kërkesa e të pandehurit për gjykim të shkurtuar është refuzuar pa të drejtë, ajo ka kompetencë të ndryshojë vendimin në lidhje me masën e dënimit, duke aplikuar nenin 406/1 të KPP-së”* (shih § 23 të vendimit).

5. Ndryshe nga sa argumenton shumica, mendoj se e drejta e aksesit dhe e drejta për t’u ankuar kundër një vendimi gjyqësor në një gjykatë më të lartë, standarde këto të sanksionuara respektivisht nga nenet 42 dhe 43 të Kushtetutës, janë dy parime me natyrë kushtetuese në thelb të ndryshme dhe me dallime të qarta nga njëra-tjetra.

6. Gjykata Kushtetuese (në vijim “Gjykata”) në jurisprudencën e saj ka theksuar se sipas nenit 42 të Kushtetutës, e drejta për akses në gjykatë të referon te e drejta që ka çdo individ për t’u drejtuar në një gjykatë që ka juridiksion të plotë për të zgjidhur çështjen. Kjo e drejtë nuk përfshin vetëm të drejtën për të filluar një proces, por edhe të drejtën për të pasur, nga ana e gjykatës, një zgjidhje përfundimtare për mosmarrëveshjen objekt gjykimi, pasi aksesit në gjykatë duhet të jetë substantiv dhe jo thjesht formal (*shih vendimet nr.14, datë 3.6.2009; nr.38, datë 30.12.2010; nr.10, datë 29.3.2011; nr. 26, datë 13.6.2011; nr. 41, datë 28.9.2011 të Gjykatës Kushtetuese*).

7. Ndërsa e drejta e ankimit në kuptim të nenit 43 të Kushtetutës, sipas jurisprudencës së Gjykatës, duhet kuptuar si një mundësi e çdo individi për të pasur mjete të caktuara procedurale për të kundërshtuar në një gjykatë më të lartë vendimin e dhënë ndaj tij nga një gjykatë më e ulët. Pra, me Kushtetutë, kujtdo i garantohet e drejta për t’u ankuar të paktën një herë kundër çdo vendimi gjyqësor të dhënë ndaj tij (shih vendimet nr.14, datë 5.7.2005; nr.5, datë 6.3.2009; nr.10, datë 29.3.2011; nr. 26, datë 13.6.2011; nr. 41, datë 28.9.2011 të Gjykatës Kushtetuese). Për këtë qëllim, dispozitat procedurale parashikojnë si mjete ankimi apelin, rekursin në Gjykatën e Lartë dhe kërkesën për rishikim (neni 407 i KPP-së), duke parashikuar aspektet formale dhe afatet procedurale për ushtrimin e këtyre mjeteve të ankimit.

8. Në këtë mënyrë, kushtetutëbërësi shqiptar, duke sanksionuar në nenin 43 të Kushtetutës të drejtën e ankimit kundër një vendimi gjyqësor në një gjykatë më të lartë ka parashikuar një standard më të lartë të mbrojtjes së të drejtave të njeriut në raport me ato të parashikuara nga neni 6 i



KEDNJ-së. Mendoj se realizimi ose jo i kësaj të drejte nga cilido individ nuk do të thotë aspak se atij i është mohuar e drejta për akses për sa kohë që ndaj tij është zhvilluar një proces gjyqësor dhe është marrë një vendim nga një gjykatë e pavarur e krijuar me ligj, për më tepër kur ky vendim ka marrë formë të prerë (përfundimtare) në gjykatën e apelit.

9. Ndryshe qëndron çështja, në këndvështrimin kushtetues, në lidhje me të drejtën për rishikim të vendimeve të formës së prerë. Sipas nenit 450 të KPP-së, e drejta për të kërkuar në Gjykatën e Lartë rishikimin e një vendimi gjyqësor të formës së prerë lidhet kryesisht me rrethana të reja të zbuluara rishtas të cilat, po të njiheshin në momentin e shqyrtimit të çështjes nga gjykatat respektive, mund të ndryshonin themelin e vendimit për shkak të deformimit të thelbit të së drejtës. Në këto raste, mendoj se realizimi ose jo i kërkesave të tilla nga kolegjet përkatëse të Gjykatës së Lartë lidhet në mënyrë të drejtpërdrejtë me të drejtën e aksesit, që do të thotë të drejtën për t'iu drejtuar gjykatës dhe për të kërkuar shqyrtimin rishtazi të çështjes në të gjitha nivelet e gjykimit. Në këto raste mund të flitet pa hezitim për një proces të parregullt në kuptimin kushtetues dhe që, për rrjedhojë, vjen në kundërshtim me nenin 42 të Kushtetutës dhe nenin 6 të KEDNJ-së.

10. Duke iu kthyer thelbit të çështjes objekt gjykimi, jam i mendimit se në rastin në fjalë Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, që ka vendosur prishjen e vendimit të Gjykatës së Apelit për Krime të Rënda, në pjesën që bën fjalë për aplikimin e nenit 406/1 të KPP-së, me arsyetimin se është marrë në kundërshtim me KPP-në, nuk i ka cenuar kërkuesve të drejtën e ankimit ndaj vendimit të ndërmjetëm të mospranimit të gjykimit të shkurtuar, e lidhur kjo me të drejtën e aksesit.

11. Kërkuesit, në kuptimin kushtetues, kanë pasur akses të plotë në gjykatë, në të gjitha shkallët e gjykimit. Ata jo vetëm kanë realizuar të drejtën për t'iu drejtuar gjykatës, por edhe të drejtën për të pasur një zgjidhje përfundimtare, përderisa ankimi i tyre është shqyrtuar dhe konsideruar jo vetëm nga gjykata e apelit por edhe nga Gjykata e Lartë.

12. Çështja që i përket kërkuesve është dëgjuar publikisht dhe brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme e krijuar me ligj, në rastin konkret Gjykata e Shkallës së Parë për Krime të Rënda dhe vendimi i marrë prej saj është ankimuar nga kërkuesit në Gjykatën e Apelit për Krime të Rënda e cila, pasi ka pranuar ankimin, ka shqyrtuar çështjen dhe ka marrë një vendim përfundimtar të formës së prerë. Duke qenë se sipas legjislacionit procedural shqiptar janë vendime përfundimtare, vendimet e gjykatave të rretheve gjyqësore të shkallës së parë, në qoftë se nuk janë ankimuar brenda afatit të ankimit, si dhe vendimet e gjykatës së apelit të cilat janë të formës së prerë, jam i mendimit se në rastin konkret me marrjen e vendimit nga ana e gjykatës së apelit, kërkuesit kanë realizuar tërësisht të drejtën e aksesit. Për rrjedhojë, nga kjo pikëpamje, mendoj se nuk mund të shtrohet për diskutim cenimi i së drejtës për një proces të rregullt ligjor, në kuptim të nenit 42 të Kushtetutës dhe nenit 6 të KEDNJ-së. Për më tepër, në rastin objekt shqyrtimi, e drejta e aksesit nuk i është cenuar kërkuesve as në Gjykatën e Lartë, përderisa pretendimet e tyre janë dëgjuar nga kjo e fundit në seancë gjyqësore duke respektuar të gjitha parimet për një proces të rregullt ligjor; pra nëpërmjet zhvillimit të një gjykimi të drejtë, publik e të paanshëm.

13. Gjithashtu, jam i mendimit se kërkuesve nuk rezulton t'i jetë cenuar as e drejta e ankimit, pasi ata e kanë ushtruar lirisht atë jo vetëm nëpërmjet ankimit në gjykatën e apelit, po edhe nëpërmjet gjykimit në Gjykatën e Lartë. Të dyja gjykatat e kanë marrë çështjen në shqyrtim duke vendosur mbi pretendimet e palëve. E drejta e ankimit nuk presupozon që gjykata duhet të pranojë kërkimet e palëve në çdo rast. Në këtë këndvështrim, Gjykata e Lartë ka ushtruar funksionin e saj si gjykatë e ligjit, duke përcaktuar normat që duhet të zbatohen ose jo gjatë shqyrtimit të ankimit ndaj vendimit të ndërmjetëm të mospranimit të gjykimit të shkurtuar.

14. Duke shkuar më tej, nga një analizë e vendimit të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, nuk rezulton se kjo e fundit i ka cenuar kërkuesve ushtrimin në mënyrë efektive të së drejtës për t'u ankuar ndaj vendimit të mospranimit të gjykimit të shkurtuar, pasi Gjykata e Lartë, ndryshe nga sa

argumenton shumica, nuk është shprehur se gjykata e apelit nuk mund të kontrollojë ligjshmërinë e ushtrimit të diskrecionit nga ana e gjykatës së shkallës së parë në marrjen e vendimit të pranimit ose jo të gjykimit të shkurtuar, si nga pikëpamja procedurale ashtu edhe substanciale.

15. Lidhur me veçoritë e shqyrtimit të ankimit ndaj vendimit të mospranimit të gjykimit të shkurtuar, në gjykatën e apelit, shoh të nevojshme të ndalem, fillimisht, në disa aspekte dhe kryesisht në *ratio* të gjykimit të shkurtuar. Ky i fundit hyn në kategorinë e gjykimeve të posaçme dhe është parashikuar nga nenet 403-406 të KPP-së. Sipas vendimit unifikues të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë nr. 2, datë 29.1.2003, gjykimi i shkurtuar ka vlerë për ekonomi gjyqësore, sepse thjeshton dhe shkurton procedurat, rrit shpejtësinë dhe efektivitetin e gjykimit dhe sjell si pasojë një përfitim për të pandehurin në uljen në 1/3 e masës së dënimit dhe mosaplikimin e dënimit me burgim të përjetshëm. Ky përfitim nuk duhet kurrsesi të shkojë në dëm të dhënies të drejtësisë.

16. Nga sa më lart, sikurse edhe shumica, mendoj se efekti kryesor që sjell aplikimi i gjykimit të shkurtuar është caktimi i një mase dënimi lehtësuese për të pandehurin (shih § 21 të vendimit). Si pasojë, në rast se gjykata e shkallës së parë nuk ka pranuar kërkesën e të pandehurit për të proceduar me këtë rit dhe ka vazhduar procedimin me gjykim të zakonshëm, i pandehuri nuk arrin të realizojë përfitimin e tij, uljen në masën 1/3 të dënimit. Kjo do të thotë se, kur gjykata e shkallës së parë rrëzon kërkesën e të pandehurit për të proceduar me gjykim të shkurtuar dhe gjykimi vazhdon me rit të zakonshëm, nuk vihet në dyshim që vendimi i dënimit të kësaj gjykate mund të apelohej nga i pandehuri, të paktën, në lidhje me masën e dënimit. Pra, i pandehuri ka të drejtë të pretendojë në apel se për shkak të refuzimit të paligjshëm të kërkesës për gjykim të shkurtuar, nuk ka pasur mundësinë të përfitojë nga ulja e dënimit edhe pse kërkesa e tij është paraqitur në formën dhe afatet e parashikuara nga ligji procedural dhe se çështja mund të zgjidhej në gjendjen që janë aktet. Për këtë arsye, meqë motivi specifik i ankimit është ligjshmëria e dënimit të dhënë nga gjykata e shkallës së parë dhe kompetencë e gjykatës së apelit është t'i japë përgjigje të gjitha shkaqeve të ngritura në ankim, i përket kësaj të fundit të bëjë rivlerësimin e masës së dënimit dhe përcaktimin konkret të këtij dënimi. Ndërsa riti procedural i gjykimit të shkurtuar, sikurse argumenton edhe shumica, është i parikuperueshëm në apel (shih § 23 të vendimit).

17. Gjykimi në gjykatën e apelit konsiston në shqyrtimin në tërësi të çështjes me qëllimin që të plotësohen mangësitë dhe të korrigjohen gabimet e gjykimit të shkallës së parë në çdo rast brenda kufijve të shqyrtimit të çështjes të përcaktuara nga nenet 422 e vijues të KPP-së. Në këtë këndvështrim, mendoj se gjykata e apelit, nëse çmon se gjykimi i shkurtuar nuk është pranuar nga gjykata e shkallës së parë për shkak të një vlerësimi të gabuar të “gjendjes së akteve”, në përcaktimin konkret të masës së dënimit ndaj të pandehurit, nuk mund të mos të marrë parasysh uljen e dënimit që i ky i fundit do të përfitonte nëse kërkesa e tij për gjykim të shkurtuar do të pranohet. Pra, nëse gjyqtari i apelit verifikon se pretendimi/ankimi i të pandehurit është i bazuar, duke bërë rivlerësimin e masës së dënimit, mund të përcaktojë si “shpërblim” për të pandehurin një ulje të masës së dënimit.

18. Nisur nga kjo premisë, në çështjen objekt shqyrtimi, përcaktimi konkret i masës së dënimit nga gjykata e apelit mendoj se duhet bërë brenda kufijve të shqyrtimit të çështjes në këtë gjykatë, të përcaktuar nga dispozitat e lartpërmendura të KPP-së, në lidhje dhe me parashikimet e sanksionuara nga neni 425 i KPP-së. Këtij neni i referohet edhe vetë shumica në arsyetimin e saj (shih § 16 të vendimit) për të përcaktuar kompetencat e gjykatës së apelit gjatë shqyrtimit të çështjes dhe është pikërisht ky nen që sanksionon kompetencat e kësaj gjykate edhe në rastin e rivlerësimit dhe përcaktimit të masës së dënimit ndaj të pandehurit.

19. Nga sa më sipër, mendoj se rivlerësimi i masës së dënimit nga gjykata e apelit në rastet kur i gjykuari nuk ka mundur të përfitojë nga avantazhet e parashikuara në nenin 406/1 të KPP-së, nuk mund të bëhet në asnjë rast mbi bazën e kritereve të këtij neni sepse zbatimi i tij është atribut



vetëm i gjykatës së shkallës së parë. Gjykata e apelit, në rast të pranimit të ankimit kundër një vendimi që refuzon aplikimin e gjykimit të shkurtuar, mund të ulë masën e dënimit duke respektuar në çdo rast kufijtë e kompetencave të saj, të parashikuara në nenin 425 të KPP-së. Ajo mund gjithashtu që, në përputhje me nenin 53 të KP-së të ulë masën e dënimit nën kufijtë e parashikuara nga ligji. Mendoj se ky është edhe kuptimi i vendimit nr. 44711, datë 27 tetor/18 nëntor 2004 i Gjykatës italiane të Kasacionit (të cilit i referohet shumica në § 24 të vendimit), kur thekson se “Përcaktimi konkret i dënimit është i rivlerësueshëm nga gjyqtari i apelit, të cilit ky pretendim i kërkohet në mënyrë specifike nga i pandehuri”.

20. Po në këtë drejtim mendoj se duhet kuptuar edhe vendimi unifikues nr.2/2003 i Gjykatës së Lartë, i referuar nga shumica, sipas të cilit “*lloji i gjykimit të ndjekur nga gjykata e shkallës së parë, pavarësisht nga vendimi i saj i ndërmjetëm lidhur me kërkesën për gjykim të shkurtuar, është i rëndësishëm për qëndrimin që duhet të mbajë gjykata e apelit për ankimin e palëve të parashikuara nga neni 406/3 i KPP-së*”. Vetëm nëse nga gjykata është proceduar efektivisht me gjykim të shkurtuar, gjyqtari i apelit mund t’i referohet nenit 406 të KPP-së; në të kundërt çmoj se duhet të aplikohen parashikimet e nenit 425 i KPP-së në përcaktimin e masës së dënimit nga gjyqtari i apelit.

21. Në këtë këndvështrim, i vetmi efekt që sjell vendimi i Gjykatës së Lartë, objekt shqyrtimi, është se gjatë shqyrtimit në gjykatën e apelit të ankimit ndaj vendimit të mospranimit të gjykimit të shkurtuar, kjo e fundit, nëse konstaton se çështja mund të vendosej në gjendjen e akteve dhe se kërkesa e të pandehurit për gjykim të shkurtuar është refuzuar pa të drejtë, në përcaktimin e masës së dënimit nuk mund të aplikojë nenin 406/1 të KPP-së. Sikurse e përmenda dhe më lart, në këtë mënyrë, Gjykata e Lartë ushtron funksionin e saj si gjykatë e ligjit, duke përcaktuar normat që nuk duhet të zbatohen në rastin konkret.

22. Nga sa më lart, jam i mendimit se vendimi i Gjykatës së Lartë nuk ka cenuar të drejtën e kërkuesve për një proces të rregullt ligjor.

Anëtar: Vladimir Kristo

VENDIM Nr.15, datë 26.3.2012

NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Vladimir Kristo	Anëtar i	Gjykatës Kushtetuese,	drejtues i seancës
Xhezair Zaganjori	Anëtar i	“	“
Petrit Pllloçi	Anëtar i	“	“
Vitore Tusha	Anëtare e	“	“
Sokol Berberi	Anëtar i	“	“
Fatmir Hoxha	Anëtar i	“	“
Altina Xhoxhaj	Anëtare e	“	“
Admir Thanza	Anëtar i	“	“

me sekretare Enina Mullaj, në datën 8.11.2011, mori në shqyrtim në seancë gjyqësore me dyer të hapura çështjen nr. 36/12 Akti, që i përket:

KËRKUES: Pranvera Loshi, e përfaqësuar nga avokat Avni Shehu, me prokurë.

SUBJEKTE TË INTERESUARA: Bajram Loshi, në mungesë.

Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Pogradec, në mungesë.

OBJEKTI: Shfuqizimi si antikushtetues i vendimit nr. 326, datë 2.6.2006 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pogradec; i vendimit nr. 286, datë 14.12.2006 të Gjykatës së Apelit Korçë dhe i vendimit nr.00-2009-206 datë 13.3.2009 të Gjykatës së Lartë.

BAZA LIGJORE: - Nenet 131/f, 134/g të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë;
- nenet 27, 28, 29 dhe 30 të ligjit nr.8577, datë 10.2.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë";
- neni 6 i Konventës Europiane të të Drejtave të Njeriut dhe neni 1 i protokollit shtesë të saj.

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoji relatorin e çështjes Admir Thanza; përfaqësuesin e kërkuarit që kërkoi pranimin e kërkesës, në mungesën e palëve të interesuara dhe pasi shqyrtoi çështjen në tërësi,

VËREN:

I

1. Subjekti i interesuar Bajram Loshi i është drejtuar me kërkesëpadi Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pogradec, me objekt konstatimin e pavlefshmërisë së veprimit juridik, fshirjen nga regjistri i Zyrës Vendore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Pogradec të regjistrimit të apartamentit të banimit në emër të kërkuarës Pranvera Loshi dhe kthimin e palëve në gjendjen e mëparshme si pasuri të përbashkët në bashkëpronësi të dy ish- bashkëshortëve.

2. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Pogradec, me vendimin nr. 286, datë 14.12.2006, ka vendosur pranimin e kërkesëpadisë.

3. Gjykata e Apelit Korçë, me vendimin nr. 286, datë 14.12.2006, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit nr. 286, datë 14.12.2006.

4. Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr.00-2009-206, datë 13.3.2009, në Dhomën e Këshillimit, ka vendosur mospranimin e rekursit të paraqitur nga kërkuarja.

5. Kërkuarja pretendon cenimin e së drejtës për një proces të rregullt ligjor, si dhe cenim të parimit të sigurisë juridike lidhur me shkeljen e të drejtës së pronës, duke parashtruar këto shkaqe:

5.1. Cenim të parimit të gjësë të gjykuar, sepse me vendimin e huaj nr.2002/4021, datë 30.5.2003 të Gjykatës së Lartë të New York-ut të njohur me vendimin nr. 3, datë 30.9.2004 të Gjykatës së Apelit Korçë, ishte vendosur jo vetëm në lidhje me çështjen e zgjidhjes së martesës dhe lënien në kujdestari të fëmijës, por edhe në lidhje me pasurinë objekt gjykim, duke iu dhënë kërkuarës e drejta ekskluzive e titullit dhe e pronësisë së kësaj pasurie të paluajtshme;

5.2. Cenim të parimit për t'u gjykuar nga një gjykatë e paanshme, sepse dy nga gjyqtarët e gjykatës së apelit që dhanë vendimin objekt kundërshtimi kushtetues kishin shfaqur mendim më parë për çështjen në gjykim për shkak se kishin qenë edhe në përbërjen e trupit gjykues që kishte dhënë vendimin nr.3, datë 30.9.2004 të Gjykatës së Apelit Korçë, që njohu dhe i dha fuqi vendimit të huaj nr.2002/4021, datë 30.5.2003 të Gjykatës së Lartë të New York-ut;

5.3. Cenim të parimeve procedurale të fuqisë provuese të një fakti të njohur zyrtarisht, sepse, në kundërshtim me nenet 10 dhe 13 të Kodit të Procedurës Civile, gjykatat nuk e çmuan dhe vlerësuan vendimin e huaj të njohur nga vendimi i gjykatës së apelit si një fakt të njohur zyrtarisht që nuk kishte nevojë të provohej.



II

1. Mbi pretendimin e cenimit të sigurisë juridike, për shkak të shkeljes së parimit të gjësë së gjykuar.

6. Lidhur me pretendimin për cenim të sigurisë juridike, për shkak të shkeljes së parimit të gjësë së gjykuar, Gjykata Kushtetuese (Gjykata) rithekson qëndrimin e mbajtur prej saj në vendimin nr. 24 datë 12.11.2008 se “vendimi gjyqësor i formës së prerë që përbën gjë të gjykuar është shprehje e konkretizim i së drejtës mbi marrëdhënien juridike dhe ka qëllim t’i japë jo vetëm qartësi, por dhe siguri kësaj marrëdhënieje. Cenimi i parimit të gjësë së gjykuar do të çonte në cenimin e të drejtave, lirive dhe interesave kushtetuese e ligjore të garantuara nga neni 42 i Kushtetutës, pra në cenim të vetë sigurisë juridike”.

7. Në rastin në shqyrtim, kërkuesja ka pretenduar cenimin e parimit të gjësë së gjykuar, pasi Gjykata e Apelit Korçë, me vendimin nr.3, datë 30.9.2004, ka njohur dhe i ka dhënë fuqi vendimit gjyqësor të huaj nr.2002/4021, datë 30.5.2003 të Gjykatës së Lartë të New York-ut, edhe në lidhje me pasurinë bashkëshortore duke ia kaluar asaj titullin e pronësisë.

8. Gjykata, referuar edhe vlerësimit të bërë nga gjykatat e sistemit të zakonshëm lidhur me njohjen e vendimit gjyqësor të huaj nr.2002/4021, datë 30.5.2003 të Gjykatës së Lartë të New York-ut, çmon se vendimi i njohjes nr. 3, datë 30.9.2004 i Gjykatës së Apelit Korçë nuk rezulton që të ketë njohur ndonjë pjesë të vendimit të huaj lidhur me kalimin e titullit të pronësisë të apartamentit të banimit, objekt gjykimi, në favor të kërkueses. Konkretisht, Gjykata e Apelit Korçë ka arritur në konkluzionin se “vendimi i gjykatës së huaj nuk përmban dispozitën që vjen në kundërshtim me nenin 394 të Kodit të Procedurës Civile”, pra në këtë vendim njohjeje nuk mund të trajtohej problemi i pronësisë, pasi kjo do të vinte në kundërshtim me legjislacionin shqiptar.

9. Në funksion të cenimit të parimit të sigurisë juridike, kërkuesja ngre dhe pretendimin për cenimin e parimit procedural të fuqisë provuese të një fakti të njohur zyrtarisht. Lidhur me këtë pretendim Gjykata çmon se vlerësimi i fuqisë provuese të një fakti të njohur zyrtarisht është çështje e juridiksionit të zakonshëm gjyqësor dhe nuk është çështje e juridiksionit kushtetues.

10. Sa më sipër, Gjykata çmon se ky pretendim duhet rrëzuar si i pabazuar.

2. Mbi pretendimin e cenimit të paanësisë në gjykim

11. Lidhur me pretendimin për cenim të paanësisë në gjykim, Gjykata thekson se parimi i paanshmërisë ka në vetvete dy elemente, atë subjektiv, që lidhet ngushtë me bindjen e brendshme që krijon gjyqtari për zgjidhjen e çështjes në gjykim, si dhe atë objektiv me të cilin kuptohet dhënia e garancive të nevojshme për një gjykim të paanshëm, duke mënjanuar çdo dyshim të përligjur në këtë drejtim.

12. Ndër të tjera, gjykata duhet të jetë e kujdesshme lidhur me çështjen e përbërjes së trupit gjykues. Paragjykimi eventual për paanësinë e gjyqtarit mund të ngrihet edhe në dyshimin se gjyqtari është shprehur në një procedim tjetër me një vlerësim që ka të bëjë me përmbajtjen e të njëjtit fakt, në lidhje me të njëjtin subjekt (*shih vendimin nr. 12, datë 13.4.2007 të Gjykatës Kushtetuese*).

13. Për sa më sipër, është i nevojshëm mënjanimi nga përbërja e trupit gjykues i gjyqtarëve që nuk kanë garancitë e kërkuara për paanshmëri në kuptimin objektiv.

14. Referuar çështjes në shqyrtim, rezulton se dy nga gjyqtarët e gjykatës së apelit që kanë dhënë vendimin objekt kundërshtimi kushtetues kanë qenë edhe në përbërjen e trupit gjykues që ka dhënë vendimin nr. 3, datë 30.9.2004 të Gjykatës së Apelit Korçë që njohu dhe i dha fuqi vendimit gjyqësor të huaj nr.2002/4021, datë 30.5.2003 të Gjykatës së Lartë të New York-ut. Lidhur me këtë fakt, kërkuesja pretendon se këta dy gjyqtarë të gjykatës së apelit kanë cenuar paanësinë në gjykim sepse kishin shfaqur mendim për çështjen në gjykim që është në kundërshtim me nenin 72 pika 4 të Kodit të Procedurës Civile.

15. Sa më sipër, Gjykata çmon se edhe pse dy nga gjyqtarët e gjykatës së apelit që kanë dhënë vendimin objekt kundërshtimi kushtetues kanë qenë edhe në përbërjen e trupit gjykues që ka dhënë vendimin nr. 3, datë 30.9.2004 të Gjykatës së Apelit Korçë, përsëri ata si çdo gjyqtar tjetër do të duhet të vlerësonin, ashtu edhe siç kanë bërë në fakt, fuqinë detyruese të një vendimi gjyqësor të formës së prerë që përbën gjë të gjykuar, brenda kufijve të përcaktuar nga ligji. Si një fakt objektiv ai nuk lë vend për diskrecion subjektiv, cilado qoftë përbërja e trupit gjykues.

16. Në këto rrethana, Gjykata çmon se pretendimi për cenim të paanësisë në gjykim duhet rrëzuar si i pabazuar.

17. Si përfundim, në vijim të arsytimit të mësipërm, Gjykata Kushtetuese vlerëson se në procesin e zhvilluar nga gjykatat e juridiksionit të zakonshëm nuk është cenuar e drejta për një proces të rregullt ligjor, në kuptim të nenit 42 të Kushtetutës dhe nenit 6 të KEDNJ-së, prandaj çmon se kërkesa e kërkueses duhet rrëzuar si e pabazuar.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të nenit 131/f të Kushtetutës dhe nenit 72 të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë” njëzëri,

VENDOSI:

- Rrëzimin e kërkesës.
- Ky vendim hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Anëtarë: Vladimir Kristo (drejtues i seancës), Xhezair Zaganjori, Petrit Pllaçi, Vitore Tusha, Sokol Berberi, Fatmir Hoxha, Altina Xhoxhaj, Admir Thanza

Abonimet vjetore për Fletoren Zyrtare mund të bëhen pranë Postës Shqiptare ose pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare, në adresën: Bulevardi “Gjergj Fishta”, mbrapa ish-ekspozitës “Shqipëria Sot”, tel: 04 24 27 007.

Çmimi i abonimit pranë Postës Shqiptare, për Fletoret Zyrtare 2012, është 16 000 lekë.
Çmimi i abonimit në QPZ është 14 000 lekë pa detyrimin e shpërndarjes në adresa.

Hyri në shtyp më 27.3.2012
Doli nga shtypi më 29.3.2012

	Formati: 61x86/8
--	------------------

Shtypshkronja e Qendrës së Publikimeve Zyrtare
Tiranë, 2012

Çmimi 22 lekë